
INFORMACION PËR TAKSAT DHE TATIMET E ZBATUESHME NË FUSHËN E SIGURIMEVE:

- Bazuar në ligjin nr. Nr. 9975, datë 28.7.2008 “Për Taksat Kombëtare” (i ndryshuar) Neni 3 - Llojet e taksave kombëtare, Pika 10, përcaktohet se janë të përjashtuara taksat mbi primet e shkruara për produktet e sigurimit të jetës.

www.tatime.gov.al/c/6/72/taksat-kombetare

- Bazuar në Ligjin 92/2014 “Për tatimin mbi vlerën e shtuar në Republikën e Shqipërisë” Neni 53 - Përjashtime për disa veprimtari të tjera, Janë furnizime të përjashtuara nga TVSH-ja transaksionet e shërbimeve të sigurimit dhe të risigurimit, përfshirë kryerjen e shërbimeve të ndërmjetësimit në sigurime dhe risigurime nga agjentët dhe brokerat e sigurimit.

www.tatime.gov.al/c/6/71/tatimi-mbi-vleren-e-shtuar

- Bazuar në Ligjin Nr. 8438, datë 28.12.1998, Për tatimin mbi të ardhurat” (i ndryshuar), Neni 20 - Shpenzime të njohura, përcaktohet se Shpenzimet e sigurimit të jetës dhe të shëndetit të punëmarrësve nga punëdhënësi konsiderohen si shpenzime të njohura.

www.tatime.gov.al/c/6/70/tatimi-mbi-te-ardhurat

Mbi pagesat e dëmeve që rrjedhin nga kontratat e sigurimeve të jetës nuk aplikohen taska ose tatime për shkak se këto pagesa nuk konsiderohen të ardhura.